

Qaushi me familje jetonte në bashkësi familjare me të ëmën dhe dy motrat e veta në **Junik**. Kur forcat serbe e sulmuan fshatin më **29.05.1998**, ai dhe disa miq iu bashkuan mbrojtjes së fshatit. Po atë ditë, diku nga ora 15:00, e plagosën në gjoks. Bashkëluftëtarët e çuan në ambulancën e UÇK-së në fshatin Dobrosh/Dobroš, por, katër ditë më vonë, gjendja e tij u keqësua dhe i ati dhe bashkëshortja e çuan Qaushin në spitalin e Gjakovës/Đakovica, ku ai iu nënshtrua intervenimit kirurgjikal. Një ditë pas ndërhyrjes kirurgjikale, më 03.06.1998, ai ndërroi jetë nga plaga e rëndë. Një ditë më vonë, familjarët e kanë varrosur Qaushin në varrezat e Gjakovës/Đakovica. Pas përfundimit të luftës, më 11.08.2000, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të tij në varrezat e Junikut/Junik.

Burimet: deklarata V.Q, FDH-19238; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; KMKKRFJ, *Personat...*, FDH-10832.

Tafil (Brahim) Kasumaj

(18.10.1950, shqiptar nga Lloqani/Loçane, komuna e Deçanit/Deçani, mësues i kimisë, katër fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Shaban (Rexhë) Kasumaj

(5.03.1954, shqiptar nga Lloqani/Loçane, komuna e Deçanit/Deçani, vozitës, katër fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Që nga fundi i muajit prill të vitit 1998, Shabani dhe Tafili, së bashku me burra të tjerë të fshatit, mbanin rojë në lokalitetin e quajtur *Kodra e Kuqe/Crveni breg*. Herët në mëngjes, në datën **29.05.1998**, forcat serbe e nisën bombardimin e **Lloqanit/Loçane**. Tafili dhe Shabani u nisën menjëherë drejt *Kodrës së Kuqe/Crveni breg*. Nuk janë kthyer më. Nga mbrëmja, shqiptarët filluan të largoheshin nga fshati. Tri ditë më vonë, fshatin e braktisën edhe bashkëshortja dhe babai i Tafilit, të cilët nuk u larguan menjëherë me shpresë që ai dhe Shabani do të ktheheshin. Familja e Tafilit u rikt-hye në fshat më 12.09.1998. Menjëherë pas kthimit, djali i Tafilit, Fatoni, me kushëririn Rinorin, shkuan te *Kodra e Kuqe/Crveni breg* dhe atje i gjetën mbetjet mortore të Tafilit dhe Shabanit. Trupi i Tafilit ishte

i djegur tërësisht, ndërkaq ai i Shabanit nga beli e të poshtë. Po atë ditë, u varrosën në oborrin e shtëpisë së Tafilit. Pas përfundimit të luftës, më 13.08.1999, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Shabanit dhe Tafilit në varrezat e fshatit Lloqan/Loçane. Një shkollë në Deçan/Deçane e mban emrin e Tafil Kasumajt.

Burimet: deklarata H.K, FDH-29225; deklarata N.N, FDH-12373; deklarata NN, FDH-12370; deklarata Z.Z, FDH-12056; KMDLNJ, *Buletini*, num. 7, prill-qershor 1998, 183, FDH-23816; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; ICTY, IT-04-84 (Haradinaj dhe të tjerë), Ex.D34, FDH-29363; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596.

Mone (Rrustë Krasniqi) Cenaj

(1920, shqiptare nga Lloqani/Loçane, komuna e Deçanit/Deçani, amvise)

Që nga vdekja e burrit në vitin 1983, Mone Cenaj jetonte te farefisi i bashkëshortit, në **Lloqan/Loçane**. Nuk kishte fëmijë. Kur forcat serbe e sulmuan fshatin më **29.05.1998**, të gjithë familjarët kaluan në Jasiq/Jasić, ndërkaq ajo ka mbetur në shtëpi. Kur familja u kthye në fshat, nga fundi i qershorit të vitit 1998, kanë dëgjuar se në fillim të qershorit, ajo gjendej në shtëpinë e Sylë Cakajt në Deçan/Deçane. Aty, sipas shpjegimeve, forcat serbe i kishin sjell personat e moshuar nga fshatrat e ndryshme përreth qytetit. Sipas këtyre burimeve, një ditë policia serbe e ka çuar Monen kinse te mjeku, sepse ajo ishte e sëmurë rëndë. Nga ajo ditë, nuk dihet asgjë për fatin e saj.

Burimi: deklarata I.C, FDH-18694.

Imer (Elez) Ukaj

(14.05.1937, shqiptar nga Vranoci i Vogël/Mali Vranovac, komuna e Deçanit/Deçani, bujk, shtatë fëmijë)

Imeri ka mbetur në fshat kur forcat serbe filluan sulmin ndaj **Vranocit të Vogël/Mali Vranovac**, në datën **29.05.1998**, diku nga ora 06:00 të mëngjesit. Familja e tij, sikur edhe bashkëfshatarët e tjerë, u largua nga fshati. Po atë ditë, nga ora 15:00, familja ka mësuar se Imeri ka pësuar nga një predhë, e cila e kishte qëlluar atë në një fushë të fshatit. Për shkak të bombardimeve të